



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2022:169340  
Datë: 24.05.2024  
Numri i dokumentit: 05729553

**PA1.nr.570/2023**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** – kolegji i përbërë nga gjyqtarët, Zyhdi Haziri kryetar i kolegjit, Skender Çoçaj dhe Abdullah Ahmeti anëtarë, me praktikanten gjyqësore Gentijana Manaj-Gashi si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit R.SH, nga Gjilani, për shkak të veprës penale Ndërtimi pa leje nga neni 359 par.3 lidhur me parag.2 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokuroria Themelore në Gjilan, e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, P.nr.797/22 i datës 16.02.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 23.05.2024, mori këtë:

**AKTVENDIM**

**I.** Me rastin e ankesës së Prokuroris Themelore në Gjilan, e sipas detyrës zyrtare anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.797/22 i datës 16.02.2023, ashtu që çështja kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

**II.** Ankesa e Prokuroris Themelore në Gjilan tani për tani mbetet e pashqyrtuar.

**A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Gjilan me aktgjykimin P.nr.797/22 me datë 27.03.2023 të akuzuarin R.SH, e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Ndërtimi pa leje nga neni 359 par.3 lidhur me parag.2 të KPRK-së dhe i ka shqiptuar dënimin me gjobë ë shumë prej 200 € (dyqind euro) të cilën gjobë detyrohet i akuzuari që ta paguaj në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari i lartcekur nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, gjykata do t'ia zëvendëson dënimin me gjobë me dënim me burgim, ashtu që një ditë burgim do të barazohet me 20€ (njëzetë euro) të dënimit me gjobë. Detyrohet i akuzuari që ta paguajë

paushallin gjyqësor në shumë prej 20 € (njëzet) euro, si si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, nga dita pasuese kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Gjykata Themelore në Gjilan me datën P.nr.797/22 me datë 27.03.2023 ka nxjerr aktvendim për përmirësimin e aktgjykimit të kësaj gjykate P.nr.797/2022, i datës 28.02.2023, me arsyetim se është përvjedhur një gabim teknik në shqiptimin e dënimit, pasi që për veprën penale Ndërtimi pa leje , nga neni 259 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së, është paraparë dënimi kumulativ, me burg dhe me gjobë, ndërsa gabimisht është shqiptuar vetëm dënimi me gjob, ashtu që, dënimi i shqiptuar duhet të jetë: me dënim kumulativ, me burg, në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh dhe me gjobë, në shumën prej 200 (dyqind) euro, të cilat dënime do të ekzekutohen pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Në mbështetje të nenit 44 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit, dënimi i shqiptuar me burg, do të zëvendësohet në dënim me gjobë, në shumën prej 300 (treqind) euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, në të kundërtën, do të ekzekutohet dënimi i shqiptuar me burg.

Kundër aktgjykimit ka paraqitur ankesë:

Prokuroria Themelore në Gjilan PP.II.nr.1284/2022 i datës 03.04.2023 për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozimin që të Gjykata e Apelit aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj, ashtu që të pandehurit të shqiptoj dënim më të lartë kumulativ, me gjobë dhe me burgim efektiv, në mënyrë që sanksioni i shqiptuar penal të jetë proporcional me peshën e veprës penale, pasojat e shkaktuara me veprën e kryer penale , si dhe përgjegjësinë dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale.

Prokurori i Apelit, me shkresën, PPA/II nr.6083/23 të datës 04.05.2023 ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar dhe ndaj të akuzuarit të shqiptohet dënim më i lartë me gjobë dhe me burg.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPRK-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

Me rastin e ankesës së Prokuroris Themelore në Gjilan dhe sipas detyrës zyrtare aktgjykimi i ankimuar duhet të anulohet, ashtu që çështja kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Prokuroria Themelore në Gjilan ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal me pretendim se gjykata e shkallës së parë nuk i ka shqiptuar të pandehurit dënim të merituar sipas ligjit, sepse dënimin e zbuti deri në atë masë e cila bie në kundërshtim me rregullat e përgjithshme për matjen , zbutjen ose ashpërsimin e dënimit dhe kufijtë e kësaj zbutje të përcaktuara me nenet 69,70,71 dhe 72 të KPRK-s. I propozon Gjykatës

së Apelit të Kosovës aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj, ashtu që të pandehurit ti shqiptaj dënim më të lartë kumulativ, me gjobë dhe me burgim efektiv, në mënyrë që sanksioni i shqiptuar penal të jetë proporcional me peshën e veprës penale, pasojat e shkaktuara me veprën e kryer penale, si dhe përgjegjësinë dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 par. 1 e 2 të KPPRK-së dhe konstatoi se në rastin konkret bëhet fjalë për shkelje lidhur me shqiptimin e sanksionit penal sa i përket llojit të sanksionit që parashihet me ligj. Kolegji vlerësoi se në rastin konkret i akuzuari R.SH është akuzuar me aktakuzë për veprën penale gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar fillimisht të akuzuarin e shpallë fajtorë për veprën penale Ndërtimi pa leje nga neni 359 par.3 lidhur me parag. 2 të KPRK-së për të cilën parashihet dënimi me gjobë dhe me burgim prej 1 (një) deri në pesë (5) vjet burgim, pra dënim kumulativ me gjobë dhe me burgim, ndërsa gjykata e shkallës së parë i shqipton dënim me gjobë si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, ndërsa kjo gjykatë me datë 27.03.2023 pra një muaj pas shpalljes së aktgjykimit ka nxjerr aktvendim P.nr.797/22 me të cilin ka përmirësuar aktgjykimin e ankimuar sa i përket llojit dhe lartësisë së sanksionit penal, me arsyetim se është përvjedhur një gabim teknik në shqiptimin e dënimit ashtu që me këtë aktvendim konstaton “pasi që për veprën penale Ndërtimi pa leje, nga neni 259 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së, është paraparë dënimi kumulativ, me burg dhe me gjobë, ndërsa gabimisht është shqiptuar vetëm dënimi me gjobë, ashtu që, dënimi i shqiptuar duhet të jetë: me dënim kumulativ, me burg, në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh dhe me gjobë, në shumën prej 200 (dyqind) euro, të cilat dënime do të ekzekutohen pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Në mbështetje të nenit 44 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit, dënimi i shqiptuar me burg, do të zëvendësohet në dënim me gjobë, në shumën prej 300 (treqind) euro.”

Kolegji vlerësoi se në rastin konkret Gjykata e Shkallës së parë pa te drejtë ka marrë aktvendim mbi përmirësimin e aktgjykimit të ankimuar, duke qenë se gabimet e konstatuara në aktvendimin mbi përmirësimin e aktgjykimit nuk konsiderohen gabime të imëta e të cilat mund të përmirësoheshin në pajtim me nenin 371 të KPPRK, këto janë gabime përmbajtjesore të cilat në tërësi e kanë ndryshuar dispozitivin e aktgjykimin të ankimuar sa i përket shqiptimit të sanksionit penal dhe atë sa i përket llojit të sanksionit që parashihet me ligj. Në këto rrethana kolegji vlerësoi se aktgjykimi i ankimuar duhet të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje, pasi që dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nuk është shqiptuar në pajtim me dispozitat ligjore të KPRK-së.

Gjykata e shkallës së parë në rigjykim duhet edhe njëherë të mbajë seancën gjyqësore ashtu varësisht nga rrjedha e procedurës gjyqësore të nxjerr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj edhe sa i sa i përket shqiptimit të sanksionit penal dhe atë sa i përket llojit të sanksionit që parashihet me ligj.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 402 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**PA1.nr.570/23, datë 23.05.2024**

Procesmbajtëse  
Gentijana Manaj-Gashi

---

Anëtarët e kolegjit  
Skender Çoçaj

---

Kryetari i kolegjit  
Zyhdi Haziri

---

Abdullah Ahmeti

---